

Zhvillohet në Universitetin e Elbasanit Java Ballkanike e Sportit në kuadër të projektit SHAPE

Në kuadër të projektit SHAPE të implementuar nga Universiteti i Elbasanit u zhvillua Java Ballkanike e Sportit, ku të rinj nga Shqipëria, Belgjika, Letonia, Franca, Finlanda dhe Spanja u bashkuan në aktivitete të mbushura me energji, sport dhe bashkëpunim.

Java Ballkanike e Sportit nisi me një sesion informues mbi Projektin SHAPE dhe Programin Erasmus+, ku u ndanë mundësitë për të mësuar, udhëtuar dhe vepruar përmes programeve evropiane. Në vijim pjesëmarrësit bashkëpunuan me studentët në zhvillimin e një sërë aktiviteteve edukative dhe sportive, të konceptuara dhe të realizuara nga vetë anëtarët e projektit SHAPE.

Përmes metodave të edukimit joformal dhe informal u ofruan momente reflektimi dhe bashkëveprimi përmes yoga-s, meditimit dhe lojërave sportive, duke nxitur vetëdijen emocionale, ekuilibrin e brendshëm, kreativitetin dhe punën në ekip.







